USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

DEMOCRACYPLUS

# MATËSI I PERFORMANCËS NË PROKURIM PUBLIK

## Për komunat - Prishtinë, Gjilan, Pejë, Gjakovë dhe Vushtrri

Shkurt 2019



NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

# MATËSI I PERFORMANCËS NË PROKURIM PUBLIK

## Për komunat - Prishtinë, Gjilan, Pejë, Gjakovë dhe Vushtrri

Shkurt 2019



**TITULLI I PROJEKTIT:** Ekspozimi i korrupsionit përmes monitorimit aktiv dhe krahasimit të pesë komunave
**DATA E PUBLIKIMIT:** Shkurt 2019
**AUTORËT:** Rrita Ismajli dhe Isuf Zejna

Opinionet e autorit të shprehura në këtë publikim jo domosdomërisht reflektojnë qëndrimin e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikes.

# PËRMBAJTJA

SHKURTESAT ....................................................................6

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .........................................7

HYRJA..................................................................................8

METODOLOGJIA .............................................................9

KUFIZIMET GJATË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE....10

ZBATIMI I LIGJIT ..........................................................12

PRAKTIKAT E MIRA .....................................................14

IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE TË INSTITUCIONEVE MBIKËQYRËSE ..............................18

TRANSPARENCA ..........................................................20

KONKURRENCA.............................................................22

PËRFSHIRJA QYTETARE............................................24

REZULTATI I PËRGJITHSHËM ...................................30

# SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| **AKK** | Agjencia Kundër Korrupsion |
| **AK** | Autoritetet Kontraktuese |
| **AQP** | Agjencia Qendrore e Prokurimit |
| **OShC** | Organizatat e Shoqërisë Civile |
| **D+** | Demokraci Plus |
| **OE** | Operatori ekonomik |
| **FOI** | Liria e informacionit |
| **ZKA** | Zyra Kombëtare e Auditimit |
| **LPP** | Ligji për Prokurimin Publik |
| **KRPP** | Komisioni për Rregullimin e Prokurimit Publik |
| **OShP** | Organi Shqyrtues i Prokurimit |

# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Si pasues i raportit "Matësi i performancës në prokurimit publik" për pesë komunat e targetuara në Kosovë, i cili ishte publikuar nga Demokracia Plus (D +) në maj të vitit 2018, D+ ka vazhduar të përcjellë performancën e zyrëtarëve të prokurimit të këtyre komunave. Pas rishikimit të indikatorëve, D+ ka nxjerrë numrin e dytë të këtij raporti, me qëllim të vlerësimit më të mirë të performancës së zyrtarëve komunal të Prishtinës, Gjakovës, Vushtrrisë, Gjilanit dhe Pejës, në prokurimin publik.

Ky raport mbulon periudhën kohore janar korrik 2018, duke theksuar praktikat më të mira, parregullsitë dhe shkeljet ligjore dhe duke u fokusuar në zhvillimet kryesore në prokurim publik të nivelit lokal. Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë se deri në çfarë shkalle këto komuna veprojnë sipas ligjit, si dhe të inkurajojë zyrtarët që t'i ndajnë me të tjerët praktikat e mira në prokurim publik.

Indikatorët dhe metodat e hulumtimit janë përcaktuar sipas metodologjisë sonë lidhur me procesin e monitorimit të prokurimit publik. Për t'i identifikuar sa më saktë parregullësitë dhe praktikat më të mira të komunave, D+ ka përgatitur një pyetësor të dytë, me disa ndryshime nga ai i pari, përmes të cilit është bërë vlerësimi i performances së zyrtarëve në prokurimin publik. Ndryshimet kryesore vërehen tek indikatorët e "Konkurrencës" dhe "Praktikave të Mira", kjo për të marrë rezultate sa më të sakta në këto fusha. Duke pasur parasysh rezultatet përfundimtare të këtij matësi të performacës, është e qartë se "Përfshirja qytetare" vazhdon të mbetet indikatori, në të cilin të gjitha komunat kanë probleme. Andaj, është jetike që komunat të krijojnë mekanizma gjithëpërfshirës për të krijuar mundësi për qytetarët që të marrin rol aktiv në monitorimin e aktiviteteve të prokurimit në qytete, shkolla, spitale dhe projekte të tjera të rëndësishme.

Qëllimi i "Matësit të performancës" është i dyfishtë. Fillimisht, ky raport paraqet të dhëna të krahasueshme lidhur me praktikat komunale që aplikohen në prokurim publik, ku matet performanca e pesë komunave. Po ashtu, i njëjti ofron informacione të hollësishme jo vetëm për publikun, por edhe për kompanitë private dhe institucionet rregullatore të prokurimit, siç janë: Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP) dhe Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK). Gjetjet e këtij raporti janë mbledhur përmes një pyetësori me të dhëna kualitative dhe kuantitative, intervistave individuale me zyrtarët komunal, diskutimeve të përgjithshme lidhur me fushën e prokurimit publik në Kosovë, si dhe burimeve dytësore nga institucione të pavarura publike, duke përfshirë këtu Zyrën Kombëtare të Auditimit, Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, Organit Shqyrtues të Prokurimit, Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe kompani private.

KOMUNAT JANË KRAHASUAR DHE ANALIZUAR DUKE U BAZUAR NË INDIKATORËT E MËPOSHTËM, RËNDËSIA E TË CILAVE SHPJEGOHET MË TEJ NË RAPORT:

1. **Zbatimi i ligjit**
2. **Praktikat e mira**
3. **Zbatimi i rekomandimeve të institucioneve mbikëqyrëse**
4. **Transparenca**
5. **Konkurrenca**
6. **Përfshirja qytetare**

# HYRJA

Botimi i parë i raportit "Matësi i performancës në prokurim publik" ofron një qasje holistike për çështjet me rëndësi, siç janë praktikat e mira në prokurim publik në nivel lokal. Me publikimin e kontratave, nismë kjo e filluar nga Komuna e Gjakovës dhe e ndjekur edhe nga 17 komuna të tjera, Kosova në vitin 2017 ka bërë një hap drejt rritjes së një trasparence të plotë dhe një konkurrence të drejtë në nivel komunal. Kjo i ka mundësuar D+ që të bëjë këtë raport të dytë duke u bazuar në më shumë të dhëna krahasuese dhe analitike. Duke u fokusuar në pesë komunat e targetuara dhe duke identifikuar parregullsitë dhe shkeljet në prokurim, D+ do të vazhdojë të sfidojë status quonë dhe të ofrojë rekomandime konstruktive për prokurim më të mirë publik.

Në dy vitet e fundit, institucionet rregullatore të prokurimit publik dhe autoritetet kontraktuese kanë marrë hapa serioz në luftimin e korrupsionit dhe në rritjen e integritetit të të gjithë sistemit. Fillimi i funksionimit të platformës së prokurimit elektronik dhe publikimi i kontratave tregojnë një vullnet të mirë në këtë drejtim. Megjithatë, siç është përmendur në raportin e kaluar, rregullimi i çështjeve thelbësore administrative dhe ofrimi i një sistemi të hapur dhe transparent në prokurim publik kërkon angazhim të vazhdueshëm. Për më tepër, përfshirja e shoqërisë civile dhe bizneseve private në të gjithë procesin e prokurimit, si në nivelin komunal ashtu edhe në atë qendror është vendimtare, në mënyrë që ta krijojmë një sistem të avancuar dhe të pakorruptuar.

Bashkëpunimi institucional ndërmjet institucioneve rregullatore, autoriteteve kontraktuese dhe shoqërisë civile vazhdon të jetë një sfidë e vërtetë e prokurimit publik. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP) dhe Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) ndikon tek autoritetet kontraktuese, qoftë përmes mospërputhjes së vendimeve të OShP-së apo mungesës së interpretimeve të KRPP-së.

**Botimi i dytë i "Matësit të performancës në prokurim publik" do të mundohet të adresojë çështje, si:**

- A është menaxhimi i kontratave efektiv në prokurimin publik të nivelit lokal?
- Deri në çfarë mase komunat i zbatojnë rekomandimet e institucioneve mbikëqyrëse?
- A ka ndonjë strategji për përfshirjen e organizatave publike dhe atyre të shoqërisë civile në monitorimin e aktiviteteve të prokurimit?

Duke u përgjigjur pyetjeve të lartpërmendura, D+ beson që ky raport do të shërbejë si mjet informues dhe si mundësi për një qasje holistike ndaj situatës në prokurimin publik në nivel komunal, e po ashtu të kontribuojë në temat aktuale për ndjekjen e korrupsionit në prokurimin publik.

# METODOLOGJIA

Në raportin e kaluar, i cili është raport bazë i monitorimit të vazhdueshëm në pesë komunat e targetuara, kemi analizuar gjetjet dhe parregullësitë më të shpeshta nëpër të cilat kalojnë aktivitetet e prokurimit. Ndërkaq, ky raport nuk e ka për qëllim vetëm t'i theksoj këto parregullsi, por gjithashtu t'i vë në pah praktikat e mira që kanë këto komuna. Prandaj, në pajtim me metoda të ndryshme hulumtuese dhe me një numër të madh të shkollave të mendimit, D+ ka vendosur një varg indikatorësh, përmes të cilave është bërë vlerësimi i komunave në spektrin e prokurimit publik, ku janë identifikuar edhe disa nga praktikat e mira në prokurim publik.

Duke bërë krahasimin e metodave të mëparshme që janë përdorur, e të cilat janë të bazuara kryesisht në analizën e burimeve sekondare, siç janë raportet vjetore dhe të dhënat statistikore, D+ ka përgatitur një pyetësor. Ky pyetësor vlerëson anën kualitative dhe kuantitative në sfera të ndryshme të prokurimit publik në këto pesë komuna, siç është zbatimi i ligjit, praktikat e mira, rekomandimet e institucioneve mbikëqyrëse, konkurrencën e lirë, transparencën dhe përfshirjen qytetare. Për më tepër, ky pyetësor përfshinë disa nën-indikatorë, ku zyrtarët e prokurimit të këtyre komunave kanë pasur mundësi të vetëvlerësohen në nivelin e efikasitetit dhe transparencës. Ky vlerësim është bërë nga numri zero (0) deri në pesë (5), ku zeroja përfaqëson performancën më të dobët të një komune, ndërkaq numri pesë(5) performancën më të mirë të saj.

Performanca e komunave në prokurim publikështe matur sipas pikëve që i janë dhënë komunave nga zero sa është minimumi, deri në 5 sa është maksimumi i mundshmëm. Rezultati i dobët dëshmon se një komunë ka performancë të dobët në prokurim publik dhe anasjelltas.

"Matësi i performancës" përfshin gjashtë indikatorë kryesor dhe 32 nën-indikatorë. Numri total i pikëve të dhëna në këtë raport janë në pajtim me çdo indikator. Për shembull, nën-indikatori i parë (zbatimi i ligjit) ka 30 pikë, ku Komuna e Pejës ka arritur rezultatin më të mirë me 17 pikë. Sidoqoftë disa nën-indikatorë kanë pikët maksimale, deri në tri ose katër pikë, ku përfshihen: "Ditët deri në vendim", "Hulumtimi i tregut", "Integriteti institucional", "Transparenca gjatë hapjes së ofertave", "Opinionet e ZKA-së", "Urdhëresat nga OShP", "Opinionet e AKK-së", "Kërkesat për qasje në dokumente publike", "Numri i ofertave" dhe "Prejardhja e ofertave.

D+ përmes palëve kryesore siç janë kompanitë, institucionet e pavarura publike si ZKA, OShP, KRPP dhe AKK, ka verifikuar të dhënat dhe përgjigjet që këto komuna kanë dhënë në pyetësor. D+ gjithashtu ka kërkuar informata zyrtare përmes të drejtave ligjore lidhur me qasjen në dokumente publike në këto pesë komuna, ku është bërë edhe kalkulimi i vonesave në kthimin e përgjigjeve në këto kërkesa. Po ashtu pjesë e raportit janë edhe intervistat me zyrtarët e prokurimit dhe zëdhënësit për informim në këto pesë komuna, si dhe me kompani të ndryshme, kjo me qëllim të trajtimit më të thellë të situatës aktuale në këtë fushë të ndjeshme.

- Analizimi i përgjigjeve në pyetësor dhe vlerësimi i tyre;
- Analizimi i të dhënave nga burimet dytësore siç janë raporti vjetor i ZKA, OShP, AKK dhe KRPP për vitin 2017;
- Diskutimet me zyrtarë të KRPP-së për të pasur një pasqyrë të qartë lidhur me monitorimin e prokurimit publik që bën ky institucion;
- Intervista me kryetarin e Bordit të OShP-së, Blerim Dina;
- Diskutimet me zyrtarët e prokurimi publik në këto pesë komuna;
- Analizimi i të gjitha ankesave që i ushtrojnë operatorët ekonomik si në autoritete kontraktuese ashtu edhe në OShP për vitin 2017;
- Analizimi i opinioneve të AKK-së lidhur me anulimin e aktiviteteve të prokurimit.

# Kufizimet gjatë mbledhjes së të dhënave

Mbledhja e të dhënave për këtë raport, sidomos për aktivitetet e prokurimit publik nuk ishte detyrë edhe aq e lehtë. Kjo sigurisht për shkak të rëndësisë ekonomike që kanë këto aktivitete, si dhe hapësirës për të bërë keqpërdorime në këtë sektor të ndjeshëm. Një ndër pengesat kryesore që kemi hasur gjatë hartimit të këtij raporti janë vonesat e zyrtarëve për t'u përgjigjur në pyetësorë. Përveç vonesave, edhe përgjigjet e dhëna kanë qenë jo të plota, në disa raste të pavërteta, e që ka paraqitur pengesë në vetvete. Fshehja e informatave publike ka qenë trend i vazhdueshëm që në fazat e para të themelimit të prokurimit publik në Kosovë. Përmirësimi i kësaj pjese lë shumë për të dëshiruar, pavarësisht angazhimit edhe të komunitetit ndërkombëtar për jetësimin e një sistemi të prokurimit të hapur dhe transparent. Që të pesë komunat çalojnë në këtë pjesë, pasi që shpesh ngurrojnë lejimin e qasjes në dokumente publike.

Moszbulimi i informacionit publik ka qenë një prirje që prej krijimit të prokurimit publik në Kosovë. Pavarësisht presionit nga shoqëria civile, mediat dhe komunitetit ndërkombëtar që prokurimin publik të jetë i hapur dhe transparent, progresi ka qenë i ngadalshëm. Të pesë komunat kanë kufizime kur është fjala për sigurimin e qasjes në informata publike për organizata, institucione dhe kompani të tjera. Megjithatë, këto pesë komuna, së bashku me 13 të tjera, kanë filluar të publikojnë vullnetarisht kontratat online qysh prej gushtit 2018, i cili paraqet një ndryshim të madh në transparencën e prokurimit publik.

Institucionet e prokurimit publik dhe komunat në kosovë duhet jo vetëm të jenë në gjendje të ofrojnë qasje në informata dhe dokumente publike, por duhet t'i publikojnë të "dhënat e hapura", pavarësisht nëse qytetarët i kërkojnë ato, apo jo. Përmirësimi i kësaj gjendjeje do t'i ndihmonte OSHC-të, kompanitë dhe publikun për t'i identifikuar dhe pastaj për t'i parandaluar aferat korruptive.

Ofrojnë qasje në informata dhe dokumente publike, por duhet t'i publikojnë të "dhënat e hapura", pavarësisht nëse qytetarët i kërkojnë ato, apo jo. Përmirësimi i kësaj gjendjeje do t'i ndihmonte OSHC-të, kompanitë dhe publikun për t'i identifikuar dhe pastaj për t'i parandaluar aferat korruptive.

# ZBATIMI I LIGJIT

Indikatori Zbatimi i Ligjit përfshin nën-indikatorë të tjerë, siç janë ‘’Kërkesat për rishqyrtim te autoritetet kontraktuese, “Ankesat’’, ‘’Të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditimit’’, etj. Duke u bazuar në analizën që kemi bërë, Komuna e Pejës ka arritur pikët më të larta, 17 nga 30 sa ishin gjithsej. Ky rezultat ka ardhur nga respektimi i kornizave ligjore gjatë procedurave të prokurimit. E ranguara e dytë në këtë aspekt është Komuna e Vushtrrisë, e cila është vlerësuar me 13 pikë. Komuna e Prishtinës dhe ajo e Gjilanit kanë marrë vetëm nga pesë pikë secila, ndërsa komuna e cila ka performancën më të dobët për këtë indikator është ajo e Gjakovës me tre pikë nga 30 pikët totale. Ky rezultat i dobët reflekton numrin e madh të ankesave në autoritete kontraktuese dhe në OShP, përfshirë këtu edhe shkeljet ligjore që i ka identifikuar ZKA.




**FIGURA 1.** Pasqyrimi i pikëve për secilën komunë lidhur me indikatorin “Zbatimi i ligjit’’.

# PRAKTIKAT E MIRA

Sa i përket indikatorit të dytë, i njohur si "Praktika e mira", komuna me performancën më të mirë është ajo e Vushtrrisë. Kjo komunë është më efikasja në kryerjen e pagesave, kërkesës së garancionit për punët, si dhe ka ngritur standarde të larta për hulumtim të tregut në krahasim me komunat tjera. E ranguara e dytë është Komuna e Prishtinës, e cila gjithashtu konsiderohet si njëra prej komunave më të përpikta sa i përket kryerjes së pagesave brenda afati ligjor.

Në vendin e tretë renditen Komuna e Gjakovës dhe ajo e Gjilanit të vlerësuara me nga 12 pikë. Komuna e Pejës ka mbledhur vetëm 10 pikë nga 43 sa ka pasur ky indikator gjithsej. Një rezultat si ky, i cili është vendosur edhe në tabelën më poshtë, ka ardhur si pasojë e mungesës së konsultimit me sektorin privat, mungesën e hulumtimit të tregut dhe aplikimit të rrallë të tenderit me çmimin më të favorshëm, kriter ky për vlerësimin e tenderit.

## PRISHTINA



| Indikatori | Pikët (shkalla 1–5) |
| --- | --- |
| Garancioni për produkte/punë | 3 |
| Hulumtimi i tregut | 0 |
| Konsultimi me sektorin privat në fazën e planifikimit | 0 |
| Trajtimi i kërkesave për ndryshim të kritereve të tenderimit | 3 |
| Konfiskimi i sigurimit për ekzekutimin e kontratës | 2 |
| Implementimi i kritereve për cilësinë | 2 |
| Efikasiteti në kryerjen e pagesave | 4 |
| Integritet institucional | 2 |
| Menaxhimi i kontratave | 4 |

## GJILAN



| Indikatori | Pikët (shkalla 1–5) |
| --- | --- |
| Garancioni për produkte/punë | 1 |
| Hulumtimi i tregut | 1 |
| Konsultimi me sektorin privat në fazën e planifikimit | 0 |
| Trajtimi i kërkesave për ndryshim të kritereve të tenderimit | 3 |
| Konfiskimi i sigurimit për ekzekutimin e kontratës | 0 |
| Implementimi i kritereve për cilësinë | 0 |
| Efikasiteti në kryerjen e pagesave | 2 |
| Integritet institucional | 2 |
| Menaxhimi i kontratave | 3 |

**FIGURA 2.** Pasqyrimi i pikëve për secilën komunë lidhur me indikatorin ''Praktikat e mira''

# PRAKTIKAT E MIRA

## PEJA



| Indikatori | Pikët |
|---|---|
| Garancioni për produkte/punë | 0 |
| Hulumtimi i tregut | 1 |
| Konsultimi me sektorin privat në fazën e planifikimit | 0 |
| Trajtimi i kërkesave për ndryshim të kritereve të tenderimit | 3 |
| Konfiskimi i sigurimit për ekzekutimin e kontratës | 0 |
| Implementimi i kritereve për cilësinë | 2 |
| Efikasiteti në kryerjen e pagesave | 2 |
| Integritet institucional | 1 |
| Menaxhimi i kontratave | 1 |

## GJAKOVA



| Indikatori | Pikët |
|---|---|
| Garancioni për produkte/punë | 1 |
| Hulumtimi i tregut | 0 |
| Konsultimi me sektorin privat në fazën e planifikimit | 0 |
| Trajtimi i kërkesave për ndryshim të kritereve të tenderimit | 0 |
| Konfiskimi i sigurimit për ekzekutimin e kontratës | 0 |
| Implementimi i kritereve për cilësinë | 0 |
| Efikasiteti në kryerjen e pagesave | 5 |
| Integritet institucional | 3 |
| Menaxhimi i kontratave | 3 |

**FIGURA 2.** Pasqyrimi i pikëve për secilën komunë lidhur me indikatorin ‘‘Praktikat e mira’’

# PRAKTIKAT E MIRA




**FIGURA 2.** Pasqyrimi i pikëve për secilën komunë lidhur me indikatorin ‘‘Praktikat e mira’’

# IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE TË INSTITUCIONEVE MBIKËQYRËSE

Indikatori që ka të bëjë me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve rregullatore përfshin nën-indikatorë të ndryshëm siç janë raporti i ZKA-së për vitin 2017, të gjeturat e auditorit të brendshëm të komunave, opinionet e AKK-së[1] dhe urdhëresave të OShP-së[2]. Sa i përket këtij indikatori, rekomandimet dhe opinionet e këtyre institucioneve më së miri janë adresuar në Komunën e Gjakovës, Vushtrrisë dhe Gjilanit. Ky indikator te Komuna e Gjilanit tregon se ka përmirësime të dukshme në këtë drejtim. Ndërkaq, dy komunat me performancën më të dobët në implementimin e tyre janë Prishtina dhe Peja, me tetë pikë nga 19 pikët totale të këtij indikatori. Ndërsa të gjitha komunat kanë marrë 0 pikë në përmbushjen e nën-indikatorit që ka të bëjë me raportet e auditorit të brendshëm, pasi asnjëra nga to nuk e ka publikuar të njëjtin. Edhe pse nuk është obligim ligjor, D+ e konsideron si njërën nga praktikat më të mira.

1 Agjencia Kundër Korrupsion, Opinion, gjendet në https://www.akk-ks.org/opinionet/99/2018/99
2 Organi Shqyrtues i Prokurimit, vendimet dhe urdhëresat e lëshuara për autoritetet kontraktuese, gjendet në https://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71




**FIGURA 3.** Pasqyrimi i pikëve për secilën komunë lidhur me indikatorin 'Zbatimi i rekomandimeve të institucineve mbikëqyrëse''

# TRANSPARENCA

Indikator tjetër me rëndësi është ai i transparencës në prokurim publik në pesë komunat e targetuara. Për këtë, gjatë analizimit të të dhënave dhe vlerësimit të përgjigjeve në pyetësor, D+ ka identifikuar që komuna e Prishtinës, jo vetëm që aplikon praktika të mira për trasparencë, por gjithashtu ka lansuar edhe platformën ''Hapja e të dhënave''. Realisht, kjo iniciativë i ndihmon qytetarët e Prishtinës që të informohen më mirë, për ta nxitur kështu sektorin privat për të ofertuar në tenderët publik. Komuna e dytë me performancën më të mirë është ajo e Gjakovës, e cila është angazhuar në përmbushjen e nën-indikatorëve të transparencës dhe gjithashtu, e njëjta është komuna e parë që ka filluar me publikimin e kontratave. E treta për nga performanca është komuna e Vushtrrisë. Ndërsa, dy komunat e fundit me performancën më të dobët janë Peja dhe Gjilani, të cilat nga 15 pikët totale kanë arritur të marrin nëntë pikë. Këto dy komuna duhet të punojnë që ta përmirësojnë këtë pjesë, në mënyrë që t'ju lejohet dhe lehtësohet qytetarëve qasja në informata publike, e atë në baza të rregullta ditore.




**FIGURA 4.** Pasqyrimi i pikëve për secilën komunë për indikatorin “Trasparenca

# KONKURRENCA

Indikatori i pestë me radhë në prokurim publik ka të bëjë me konkurrencën e lirë. Të gjitha komunat e Kosovës duhet t'i ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për t'u siguruar që konkurrenca nuk përcaktohet përmes përkatësive politike, por vetëm me meritokraci dhe ofertim të drejtë. Lidhur me këtë, komuna e Prishtinës ka arritur numër më të madh të pikëve në krahasim me komunat tjera. Ndërsa, komuna e Pejës ka bërë përmirësimet më të mëdha në kuptim të indikatorit të konkurrencës, duke dalë kështu nga vendi i pesë, në të cilin ishte ranguar në vlerësimin e parë të perfomancës për këtë indikator, në vendin e dytë. Vendin e tretë në performancë për këtë indikator e zënë Vushtrria dhe Gjakova, të cilat gjithashtu aplikojnë praktika të përshtatshme sa i përket konkurrencës. Edhe komuna e Gjilanit ka praktika të mira për realizimin e një konkurrence të lirë, por duhet të bëhet akoma më shumë sidomos sa i përket numrit të ofertave, në mënyrë që punët të kryhen nga një numër më i madh i kompanive në vend, e jo të agazhohen vetëm kompanitë e njëjta.




**FIGURA 5.** Pasqyrtimi i pikëve për secilën komunë lidhur me indikatorin e ''Konkurrences''

# PËRFSHIRJA QYTETARE

Indikatori i fundit i kësaj analize ka të bëjë me përfshirjen qytetare në procedurat e prokurimit publik. Komunat luajnë rol të rëndësishëm si rregullator social dhe si blerës në treg. Qytetarët, OShC-të dhe mediat kanë ndikim në mbikëqyrjen e një procesi në prokurim publik, gjë e cila është në kuadër të të drejtave të tyre pë t'u informuar për aktivitetet publike. Në përgjithësi, këto komuna duhet të krijojnë një mënyrë se s'i të ndërveprojnë me publikun dhe të sigurohen që qytetarët të jenë të informuar për punët që kryhen për interes të përgjithshëm. Në këtë fushë, këto komuna nuk dallojnë shumë nga njëra-tjetra. Megjithatë, për dallim nga vlerësimi i kaluar, përmirësime të dukshme në këtë drejtim janë vërejtur në Vushtrri dhe Gjakovë. Pavarësisht kësaj, kërkohet angazhim më i madh lidhur me përfshirjen e qytetarëve dhe informimit të tyre për projektet dhe aktivitetet e prokurimit.

**PRISHTINA**



| Indikatori | Pikët (1–5) |
|---|---|
| Transparenca në vlerësimin e tenderëve | 3 |
| Transparenca gjatë hapjes së ofertave | 3 |
| Konsultime para hartimit të planifikimit të prokurimit | 2 |
| Monitorimi në fazat pas dhënies së kontratës | 0 |
| Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit | 0 |

**GJILAN**



| Indikatori | Pikët (1–5) |
|---|---|
| Transparenca në vlerësimin e tenderëve | 3 |
| Transparenca gjatë hapjes së ofertave | 2 |
| Konsultime para hartimit të planifikimit të prokurimit | 2 |
| Monitorimi në fazat pas dhënies së kontratës | 0 |
| Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit | 0 |

**PEJA**



| Indikatori | Pikët (1–5) |
|---|---|
| Transparenca në vlerësimin e tenderëve | 4 |
| Transparenca gjatë hapjes së ofertave | 2 |
| Konsultime para hartimit të planifikimit të prokurimit | 2 |
| Monitorimi në fazat pas dhënies së kontratës | 0 |
| Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit | 0 |

**GJAKOVA**



| Indikatori | Pikët (1–5) |
|---|---|
| Transparenca në vlerësimin e tenderëve | 4 |
| Transparenca gjatë hapjes së ofertave | 3 |
| Konsultime para hartimit të planifikimit të prokurimit | 0 |
| Monitorimi në fazat pas dhënies së kontratës | 2 |
| Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit | 0 |

**VUSHTRRIA**



| Indikatori | Pikët (1–5) |
|---|---|
| Transparenca në vlerësimin e tenderëve | 3 |
| Transparenca gjatë hapjes së ofertave | 3 |
| Konsultime para hartimit të planifikimit të prokurimit | 2 |
| Monitorimi në fazat pas dhënies së kontratës | 1 |
| Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit | 0 |

**FIGURA 6.** Pasqyrimi i pikëve për secilën komunë lidhur me indikatorin ''Përfshirja qytetare''

# REZULTATI I PËRGJITHSHËM

Që të kuptohet më mirë situata e prokurimit publik në Kosovë, ky raport fillimisht do të ofrojë një pasqyrë mbi këtë sektor, duke komentuar zhvillimet kryesore dhe çështjet që kërkojnë angazhim më të madh. Pjesa e tretë dhe e katërt do të elaborojë pjesën e metodologjisë që është përdorur në këtë raport, ku ka pasur mjaft kufizime gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave. Kjo e fundit duhet theksuar, në mënyrë që t'i nxisë autoritetet publike që të ofrojnë qasje në informata dhe dokumente publike.

Për fund, faza e parë e raportit "Matësi i performacës" jep një pasqyrë të qartë mbi problemet e prokurimit publik në komunat e Prishtinës, Gjakovës, Vushtrrisë, Gjilanit dhe Pejës. Në të njëjtat është bërë përpjekje për ta përmirësuar prokurimin publik, pavarësisht faktit që duhet akoma më shumë punë për të krijuar një konkurrencë të drejtë në aktivitetet e prokurimit, trasparencë dhe dhënie të përgjegjësisë për çfarëdo shkelje. Edhe pse disa hapa veç janë ndërmarrë në këtë aspekt, siç është publikimi i kontratave dhe hapjes së të dhënave, mungesë të rezultateve kemi hasur sidomos te faza pas dhënies së kontratës, përkatësisht në fazën e ekzekutimit dhe menaxhimit të kontratës. Në këtë rast, ajo çka komunat duhet të ndërmarrin është publikimi i raporteve nga procesi i menaxhimit të kontratave dhed publikimi i dokumenteve, duke përfshirë këtu edhe faturat. Dokumente të tjera me rëndësi janë edhe raportet e vlerësimit të tenderëve.

Për ta pasur një pasqyrë më të qartë për performancën e komunave, në tabelën e mëposhtme do të pasqyrohen rezultatet e çdo nën-indikatori në përputhje me rrethanat.

Edhe pse disa hapa veç janë ndërmarrë në këtë aspekt, siç është publikimi i kontratave dhe hapjes së të dhënave, mungesë të rezultateve kemi hasur sidomos te faza pas dhënies së kontratës, përkatësisht në fazën e ekzekutimit dhe menaxhimit të kontratës.

| | | PRISHTINA | GJILAN | PEJA | GJAKOVA | VUSHTRRI |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **INDICATOR I** Zbatimi i ligjit | Kërkesat për rishqyrtim në AK | 0 | 0 | 4 | 0 | 0 |
| | Ditët deri në marrje të vendimit | 3 | 3 | 2 | 2 | 3 |
| | Kërkesat e aprovuara në AK | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| | Ankesat në OShP | 0 | 0 | 5 | 0 | 4 |
| | Ankesat e aprovuara në OShP | 0 | 0 | 5 | 0 | 3 |
| | Të gjeturat e Zyrës së Auditorit | 1 | 1 | 1 | 0 | 2 |
| | **Nënrezultate** | **5** | **5** | **17** | **3** | **13** |
| **INDICATOR II** Praktikat e mira | Garancioni për produkte/punë | 3 | 1 | 0 | 1 | 5 |
| | Hulumtimi i tregut | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 |
| | Konsultimi me sektorin privat në fazën e planifikimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Trajtimi i kërkesave për ndryshim të kritereve të tenderimit | 3 | 3 | 3 | 0 | 3 |
| | Konfiskimi i sigurimit për ekzekutimin e kontratës | 2 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| | Implementimi i kritereve për cilësinë | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| | Efikasiteti në kryerjen e pagesave | 4 | 2 | 2 | 5 | 5 |
| | Integritet institucional | 2 | 2 | 1 | 3 | 2 |
| | Fushata për rritjen e vetëdijes | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Menaxhimi i kontratave | 4 | 3 | 1 | 3 | 1 |
| | **Nënrezultate** | **20** | **12** | **10** | **12** | **22** |
| **INDICATOR III** Implemetini i rekomandimeve të institucioneve mbikëqyrëse | Numri i rekomandimeve të auditorit të brenshëm | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Opinionet e ZKA | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 |
| | Implementimi i rekomandimeve të ZKA | 3 | 3 | 3 | 4 | 3 |
| | Urdhëresat e OShP | 1 | 3 | 0 | 4 | 4 |
| | Opinionet e AKK | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 |
| | **Nënrezultate** | **8** | **10** | **8** | **12** | **11** |

**FIGURA 7.** Pasqyrimi i pikëve për secilën komunë në të gjithë nënindikatorët.

| | | PRISHTINA | GJILAN | PEJA | GJAKOVA | VUSHTRRI |
|---|---|---|---|---|---|---|
| INDICATOR IV Transparenca | Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| | Lejimi i qasjes në dokumente zyrtare | 5 | 3 | 3 | 4 | 4 |
| | Ueb-faqja e komunës | 5 | 3 | 3 | 5 | 4 |
| | **Nënrezultate** | 15 | 11 | 11 | 14 | 13 |
| INDICATOR V Konkurrenca | Numri i ofertave | 5 | 4 | 5 | 4 | 2 |
| | Barazia në trajtim | 4 | 3 | 3 | 4 | 5 |
| | Numri i ofertave të përgjegjshme | 4 | 5 | 4 | 4 | 4 |
| | **Nënrezultate** | 13 | 12 | 12 | 12 | 11 |
| INDICATOR VI Përfshirja qytetare | Transparenca në vlerësimin e tenderëve | 3 | 3 | 4 | 4 | 3 |
| | Transparenca gjatë hapjes së ofertave | 3 | 2 | 2 | 3 | 3 |
| | Konsultime para hartimit të planifikimit të prokurimit | 2 | 2 | 2 | 0 | 2 |
| | Monitorimi në fazat pas dhënies së kontratës | 0 | 0 | 0 | 2 | 1 |
| | **Nënrezultate** | 8 | 7 | 8 | 9 | 9 |
| | **TOTAL POINTS** | **69** | **57** | **66** | **62** | **79** |
| | **Percentage** | 48% | 40% | 46% | 43% | 55% |

# MATJA E PROGRESIT

Metodologjia e raportit për "Matjen e Performancës" është dizajnuar për të përcjellur progresin e komunave në praktikat që ato aplikojnë në prokurim publik. Praktikat e mira miratohen çdo vit nga ana e autoriteteve kontraktuese, e atë me kerkesë të publikut për më shumë përgjegjësi, transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e financave publike. Prandaj, D+ konsideron se matja e progresit të praktikave të prokurimit publik ka rëndësi të veçantë, pasi na ofron informata të bazuara në fakte se çfarë është përmirësuar dhe cilat fusha kërkojnë vëmendje më të madhe.

Në maj të vitit 2018, D+ ka publikuar raportin e parë të matjes së performancës në prokurim publik me të dhëna të grumbulluara për vitin 2017. Të dhënat tregojnë se prokurimi publik në Kosovë është relativisht transparent, ku ka numër të madh të ofertuesve, që ofertojnë në aktivitete të prokurimit. Megjithatë, niveli i zbatimit të ligjeve ishte i dobët, gjë që ka reflektuar me pakënaqësi të shumta të operatorëve ekonomik dhe që kanë gjetur mbështetje edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Ky raport analizon të dhënat për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, gjë që pamundësohen krahasimin e tërësishëm me raportin e kaluar, në të cilin janë analizuar të dhëna për gjithë vitin 2017. Kontribut të mëtejmë në këtë drejtim kanë dhënë faktorët në vazhdim, si: (1) Zakonisht, pjesa e dytë e vitit ka volum më të madh të investimeve kapitale, prandaj edhe ka numër më të madh të aktiviteteve të prokurimit e gjithashtu mundësi më të mëdha që të ketë parregullësi; dhe (2) Disa nga nën-indikatorët janë modifikuar nga hera e kaluar dhe disa të tjerë janë shtuar, duke u bërë pjesë e metotologjisë.

Niveli i zbatimit të ligjeve ishte i dobët, gjë që ka reflektuar me pakënaqësi të shumta të operatorëve ekonomik dhe që kanë gjetur mbështetje edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Gjithsesi, për ta bërë krahasimin, D+ ka rishkallëzuar rezultatin. Kjo gjë na lejon t'i përcjellim trendet për secilin indikator në çdo komunë.

Sfidat në prokurim publik janë identifikuar në pesë komunat edhe për pjesën e parë të vitit 2018. Pavarësisht sfidave, në këtë sektor është bërë edhe progres, sidomos në rritjen e transparencës, si masë parandaluese ndaj aferave korruptive. Hapi më i rëndësishëm është publikimi i planeve të prokurimit dhe kontratave në ueb-faqet e pesë komunave, gjë që dëshmon se të njëjtat kanë vullnet për të bërë më shumë për trasparencën. Nga ana tjetër, të dhënat tona tregojnë se në disa raste ka pasur rënie të trendeve, gjë që i kontribuon edhe fakti që disa nën-indikatorë janë modifikuar.

## PRISHTINA



Krahasimi i rezultateve me raportin e kaluar tregon që Komuna e Prishtinës ka pasur përmirësime. Megjithate, regres është vërejtur në implementimin e rekomandimeve të institucioneve mbikëqyrëse dhe aplikimin e praktikave të mira. Në indikatorët e tjerë, Prishtina shënon rezultat të ngjashëm me rezultatet e raportit paraprak.




**FIGURA 8.** Pasqyron krahasimin e rezultateve të Komunës së Prishtinës mes dy raporteve për matje të performancës

## GJAKOVA



Gjakova është komuna e parë që ka vendosur të hapë kontratat. Ky vendim ishte marrë në kohën kur ekipi jonë ishte duke e plotësuar pyetësorin e dytë, së bashku me zyrën e prokurimit të Komunës së Gjakovës, pasi është siguruar që publikimi i kontratave nuk përbën zbulim të sekretit afarist. Në tre nga gjashtë indikatorët, Gjakova ka treguar progres me theks të veçantë në trasparencë, e cila ka iniciuar trendin e publikimit të kontratave.




**FIGURA 9.** Pasqyron krahasimin e rezultateve të Komunës së Gjakovës mes dy raporteve për matje të performancës

## GJILAN



